



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.3

10 shkurt

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.24, datë 11.1.2012	Për pagesën e detyrimit financiar investitorëve italianë I.C.M.A. s.r.l. dhe AGRI.BEN. s.a.s., ortakë në ish-shoqërinë e përbashkët “Pranvera” sh.p.k., Sukth, Durrës.....	75
Vendim i KM nr.25, datë 11.1.2012	Për miratimin e kriterëve të vlerësimit të garës, të dokumenteve standarde dhe strukturës së Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve, për dhënien e licencës për Lotarinë Kombëtare.....	75
Vendim i KM nr.26, datë 11.1.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.248, datë 27.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, të ndryshuar.....	87
Vendim i KM nr.27, datë 11.1.2012	Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta.....	88
Vendim i KM nr.30, datë 18.1.2012	Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2012.....	91
Vendim i KM nr.32, datë 18.1.2012	Për kalimin e titullit të pronësisë së sipërfaqes prej 900 m ² , të ndodhur në zonën kadastrale 2529, me numër pasurie 737/3, Lundër, Tiranë, që do të tjetërsohet në favor të subjektit kërkues “Union Group” sh.p.k., për llogari të fondit të kompensimit financiar.....	91
Vendim i KM nr.33, datë 18.1.2012	Për kalimin e titullit të pronësisë së sipërfaqes prej 382 m ² , të ndodhur në zonën kadastrale 2529, me numër pasurie 568/12, Lundër, Tiranë, që do të tjetërsohet në favor të subjektit kërkues “Union Group” sh.p.k., për llogari të fondit të kompensimit financiar.....	92

Vendim i KM nr.36, datë 18.1.2012	Për një ndryshim në vendimin nr.1210, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kuman, të qarkut të Fierit”....	93
Vendim i KM nr.37, datë 18.1.2012	Për një ndryshim në vendimin nr.167, datë 10.3.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Kukës, të qarkut të Kukësit”.....	93
Vendim i KM nr.38, datë 18.1.2012	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Arëz” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	94
Vendim i KM nr.39, datë 18.1.2012	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes të Ministria e Brendshme, për prefektin e qarkut të Kukësit, të pronës nr.481, me emërtim “Dega e mobilizimit”, me vendndodhje në Krumë, Has dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	95
Vendim i KM nr.52, datë 1.2.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, të ndryshuar.....	96
Vendim i KM nr.59, datë 1.2.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Financave, për ngritjen e sistemit të monitorimit dhe fiskalizimit të lojërave të fatit në Shqipëri	101
Urdhër i MB nr.11, datë 18.1.2012	Për delegim kompetencash.....	102
Vendim i ERE nr.1, datë 16.1.2012	Për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë KESH sh.a. për transferimin e aseteve, përkatësisht: “Nënstacioni Lanabregas”, “Nënstacioni Bogovë”, “Nënstacioni Gjanç”, “Nënstacioni Bushat 110/20kv”, “Rrjeti 20 kv Koplík”, “Nënstacioni Shkodër 110/20kv”, “Nënstacioni Fier 110/20kv”, “nënstacioni Gjirokastër”, “Nënstacioni 110/20kv Sarandë” tek shoqëria “CEZ shpërndarje” sh.a.....	102
Vendim i ERE nr.2, datë 16.1.2012	Për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike me seri PM09SH, nr.77, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.23, datë 25.3.2009 për shoqërinë KESH sh.a.....	103

Vendim i ERE nr.3, datë 16.1.2012	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Peshku Picar 1” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Picari 1”.....	104
Vendim i ERE nr.4, datë 16.1.2012	Për kualifikimin e impiantit prodhues “Hec Klos” të shoqërisë “Malido Energji” sh.p.k. si burim i rinovueshëm energjie.....	105
Vendim i ERE nr.5, datë 16.1.2012	Për licencimin e shoqërisë “Malido Energji” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.....	106
Vendim i ERE nr.6, datë 16.1.2012	Për modifikimin e licencës për ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centralit elektrik, si dhe prodhimit të energjisë elektrike me seri NPM06K, nr.41, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.83, datë 27.11.2006 për shoqërinë Energo–Sas sh.p.k.....	107
	Vendim për shpallje të zhdukur të shtetasit Nazmi Gazidedja.....	107

VENDIM
Nr.24, datë 11.1.2012

**PËR PAGESËN E DETYRIMIT FINANCIAR INVESTITORËVE ITALIANË I.C.M.A.
S.R.L. DHE AGRI.BEN. S.A.S., ORTAKË NË ISH-SHOQËRINË E PËRBASHKËT
“PRANVERA” SHPK, SUKTH, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pagesën e detyrimit financiar investitorëve italianë I.C.M.A. s.r.l. dhe AGRI.BEN. s.a.s., ortakë në ish-shoqërinë e përbashkët “Pranvera” sh.p.k., Sukth, Durrës, në vlerën 1 857 001 (një milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e një) USD, vlerë për të cilën është rënë dakord sipas marrëveshjes së negociimit me këta investitorë, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Detyrimi financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2012.

3. Procedura e pagesës dhe afati të jetë sipas marrëveshjes së negociimit të datës 7.10.2011, ndërmjet investitorëve italianë I.C.M.A. s.r.l., dhe AGRI.BEN. s.a.s., dhe Republikës së Shqipërisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.25, datë 11.1.2012

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË GARËS, TË DOKUMENTEVE
STANDARDE DHE STRUKTURËS SË KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE,
PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR LOTARINË KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 27 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve të vlerësimit të garës, të dokumenteve standarde dhe strukturës së Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve, për dhënie e licencës për lotarinë kombëtare, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.



2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. Të përgjithshme

Ministria e Financave është autoriteti i autorizuar, këtu e më poshtë referuar si “Autoriteti”, për organizimin e procedurave të garës për shpalljen e fituesit që do të pajiset me licencë për organizimin e Lotarisë Kombëtare, këtu e më poshtë referuar si “Lotaria”.

Çdo person juridik, apo bashkim personash juridikë, vendas ose të huaj, që kërkojnë të pajisen me licencë për lotari, duhet të aplikojnë pranë Autoritetit dhe të plotësojnë kushtet e përcaktuar në ligjin nr.10 033 datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar (këtu e më poshtë referuar si ligji), këtë dokument dhe akteve të tjera të dala në zbatim të ligjit.

Në këtë dokument, referencat në ndonjë akt përfshijnë çdo ndryshim të atij akti.

1.1 Aplikuesi dhe aplikimi

Aplikuesi është çdo person juridik apo bashkim personash juridikë, vendas apo të huaj, që kërkon të licencohet për lotari dhe që paraqet aplikim pranë Autoritetit për këtë qëllim.

Autoriteti në dokumentet e tenderit përcakton kushte në lidhje me shmangien e konfliktit të interesit ndërmjet aplikuesit dhe anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve apo konsulentit.

Aplikimi përbëhet nga tërësia e dokumenteve të përcaktuara në këtë dokument, në të cilin përfshihen dhe dokumentet që Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve, këtu e më poshtë referuar si “Komisioni”, do t’i kërkojnë një aplikuesi si kusht për shqyrtimin dhe marrjen e një vendimi për licencim, në formën dhe sipas kushteve të përcaktuara në këtë dokument.

1.2 Anëtari kryesues i bashkimit të përkohshëm

Aplikuesi mund të paraqitet në formën e një bashkimi të përkohshëm, këtu e më poshtë referuar si bashkimi, të përbërë nga disa persona të tjerë juridikë. Bashkimi duhet të caktojë dhe të autorizojë njërin nga anëtarët e tij si kryesues, për të përfaqësuar dhe për të marrë përsipër, në mënyrë të parevokueshme, detyrime në emër të të gjithë anëtarëve të bashkimit për të gjitha çështjet në lidhje me procesin e shqyrtimit të aplikimit, përfshi dhe licencimin, duke përfshirë, ndër të tjera, dorëzimin e aplikimit në formën e kërkuar. Bashkimi duhet të normalizohet me anën e një kontrate noteriale të nënshkruar nga persona të autorizuar rregullisht nga shoqëritë që përbëjnë këtë bashkim.

1.3 Ndalim i pjesëmarrjes në disa bashkime të përkohshme të shoqërive

Në rast bashkimi, asnjë anëtar i tij nuk mund të marrë pjesë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në një bashkim tjetër që aplikon për të njëjtin aktivitet, apo të paraqesë i vetëm një aplikim. Në rast se një gjë e tillë verifikohet, do të rezultojë në skualifikimin e aplikimit si të aplikuesit, ashtu dhe të bashkimit ku ky aplikues bën pjesë.

1.4 Kostot

Aplikuesi do të përballojë të gjitha kostot në lidhje me përgatitjen dhe dorëzimin e aplikimit, duke përfshirë, ndër të tjera, të gjitha kostot dhe shpenzimet në lidhje me përgatitjen e përgjigjeve të pyetjeve apo kërkesave për sqarime a takime të Autoritetit.

1.5 Publikimi dhe konsulenca

Njoftimi për konkurrim në lojërat e fatit për lotari kombëtare, publikohet në dy numra radhazi, të paktën në një gazetë të huaj me qarkullim ndërkombëtar, në dy gazeta që botohen në vendin tonë, si dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Njoftimi duhet të përmbajë:

- a) vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumenteve;
- b) gjuhën e paraqitjes së dokumenteve;
- c) mënyrën e paraqitjes së dokumenteve;
- ç) vendin, orën dhe datën e shqyrtimit të dokumenteve.

Kostoja e publikimit parapaguhet nga Ministria e Financës, shpallet në dokumentet e garës dhe rimbursohet nga aplikuesi i shpallur fitues, jashtë tarifës, që do të paguajë për marrjen e licencës.

Autoriteti përzgjedh një konsulent të huaj ndërkombëtar, që asiston procesin e publikimit të dokumenteve të garës, vlerësimin e aplikimeve dhe përzgjedhjen e fituesit, si dhe në negociimin e kontratës me këtë të fundit.

Kostoja e konsulencës shpallet në dokumentet e garës dhe mbulohet nga aplikuesi i shpallur fitues, jashtë tarifës që do të paguajë për marrjen e licencës.

2. Përgatitja

2.1 Gjuha e aplikimit dhe fazat e organizimit të garës

Aplikimi, ku përfshihet dhe e gjithë korrespondenca dhe dokumentet në lidhje me këtë aplikim duhet të jenë në gjuhën shqipe ose angleze, përveç materialeve të botuara (p.sh. broshurat), të paraqitura nga aplikuesi, të cilat mund të jenë edhe në gjuhë të tjera, por sidoqoftë ato duhet të shoqërohen me përkthim, të vërtetuar, në gjuhën shqipe ose angleze.

Procesi i garës organizohet në dy faza, gjatë të cilave Autoriteti ndërmerr vlerësim të detajuar për secilin aplikim. Gjatë zhvillimit të fazave, aplikuesit mund t'i kërkohet të japë informacione shtesë me shkrim, për të qartësuar aspekte të veçanta të aplikimit.

2.2 Faza I: Kriteret e kualifikimit

Qëllimi i kësaj faze është identifikimi i aplikuesve që kanë burimet dhe kualifikimet e nevojshme për aspektet e standardeve të industrisë së lojërave të fatit e të zbatuara nga Shoqata Botërore e Lotarive, (WLA), Lotarisë Shtetërore Europiane dhe Shoqata TOTO (EL).

Aplikuesi paraqet prova që i plotëson kriteret e mëposhtme të kualifikimit, këtu e më poshtë referuar si “Kriteret”;

- Kriteret ligjore

Aplikuesi duhet të jetë i organizuar në formën e një shoqërie tregtare, ose nëse është bashkim i përkohshëm, dokumentin që e formalizon këtë bashkim.

Aplikuesi, ose nëse është bashkim, çdo anëtar i tij, nuk duhet të jetë në proces falimentimi ose likuidimi.

- Përvoja

Dokumentin e regjistrimit si shoqëri tregtare nga organi që me ligj është i autorizuar të mbajë dhe të administrojë regjistrin e shoqërive tregtare në një vend, ose nëse aplikuesi është një bashkim, kontratën noteriale ndërmjet anëtarëve të bashkimit.

- Dokumenti për falimentin

Aplikuesi, ose nëse është bashkim, çdo anëtar i tij, duhet të paraqesë një vetëdeklarim se nuk është në proces falimentimi apo likuidimi.



Kriteret kualifikuese	Dokumentet/formularët e kërkuar
<p>KK.1: Kriteri teknik 1 Aplikuesi ose nëse është bashkim i përkohshëm, të paktën anëtar i kryesues duhet të ketë eksperiencë në fushën e lojërave të fatit për të paktën në 15 (pesëmbëdhjetë) vitet e fundit të veprimtarisë së tij, si dhe prej të paktën 5 vitesh në organizimin e lojërave nëpërmjet platformës së internetit.</p>	<p>DKK1: Përvoja Ofertuesi duhet të paraqesë një kopje të noterizuar të lejes për ushtrimin e veprimtarisë si i licencuar për lotari kombëtare duke plotësuar formularin sipas specifikimeve që do të jepen në dokumentet e garës, në mënyrë që të tregojë se ai e plotëson këtë kriter. Dokumenti duhet të jetë i lëshuar nga autoriteti përkatës i vendit ku aplikuesi, apo nëse aplikuesi është një bashkim i përkohshëm anëtar i që ka këtë leje, ka selinë qendrore</p>
<p>KK.2: Kriteri teknik 2 Aplikuesi ose nëse aplikuesi është bashkim i përkohshëm, të gjithë anëtarët e bashkimit, duhet të vërtetojnë origjinën e kapitaleve të tyre.</p>	<p>DKK2: Burimi i kapitalit Aplikuesi dhe/ose anëtarët e bashkimit nuk duhet të jenë dënuar apo nuk janë në një proces gjyqësor për pastrimin e parave. Ata duhet të paraqesin të paktën të dhënat e parashikuara në dokumentet e garës, në mënyrë që të tregojë se e plotëson këtë kriter.</p>
<p>KK.3: Kriteri teknik 3 Aplikuesi ose nëse është bashkim i përkohshëm, të paktën anëtar i kryesues duhet të jetë i pajisur me certifikatë për aspektet e standardeve të zbatuara nga shoqata Botërore e Lotarisë apo shoqata e Lotarive Europiane.</p>	<p>DKK3: Certifikatat Aplikuesi, ose nëse është bashkim i përkohshëm, të paktën anëtar i kryesues duhet të paraqesin kopje të noterizuara të certifikatave të mëposhtme: 1. Certifikatën për lojë të përgjegjshme, të paktën të nivelit 4, sipas standardeve të Shoqatës Botërore të lotarive (World Lottery Association (WLA)) ose certifikatën për lojë të përgjegjshme sipas standardeve Europiane për lojë të përgjegjshme të Lotarive Shtetërore Europiane (European State Lotteries (EL)) dhe shoqatës Toto. 2. Aplikanti duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve të Shoqatës së Lotarisë Kombëtare për përmbushje të kriterëve të aplikimit sipas Standardeve të Sigurimit të Kontrollit të Shoqatës Botërore të Lotarisë: 2006 (WLA SCS:2006) minimumi gjatë tri viteve të fundit.</p>
<p>KK.4: Kriteri financiar 1 Aplikuesi ose nëse aplikuesi është bashkim i përkohshëm, të paktën shoqëria kryesuese, duhet të ketë pasur xhiro¹ të paktën 500 milionë euro të licencës për secilin prej tri (3) viteve të plota financiare të fundit.</p>	<p>DKK4/DKK5: Pasqyrë financiare e audituar Aplikuesi, ose nëse aplikuesi është një bashkim i përkohshëm, të paktën shoqëria kryesore duhet të paraqesë pasqyra financiare të audituara, të certifikuara nga ekspert(ë) kontabël, për tri (3) vitet e plota financiare të fundit, aty ku është e mundur, duke përfshirë bilancet e konsoliduara, pasqyrat e të ardhurave, pasqyrat e qarkullimit të parasë dhe shënimet kryesore shoqëruese.</p>
<p>KK.5: Kriteri financiar 2 Aplikuesi ose nëse aplikuesi është bashkim i përkohshëm, të paktën anëtar i kryesues, duhet të ketë pasur vlerën neto të aseteve² të paktën 50 milionë euro në fund të secilit prej tri (3) viteve të plota financiare të fundit.</p>	

¹ “Xhiro vjetore” është qarkullimi i aplikuesit në një vit financiar.

² “Vlera neto e aseteve”: do të thotë vlerën e aseteve minus detyrimeve të subjektit përkatës në një vit financiar.

Kriteret kualifikuese	Dokumentet/formularët e kërkuar
<p>KK.6: Kriter financiar 3</p> <p>Aplikuesi duhet të paraqesë së bashku me aplikimin e tij, një garanci të aplikimit në masën prej 3 milionë eurosh, në formë dhe përmbajtje që kërkohet nga Autoriteti.</p>	<p>Aplikuesi paraqet garancinë e aplikimit në formën e garancisë bankare. Shuma e vënë si garanci është lehtësisht e ekzekutueshme nga Autoriteti.</p> <p>Garancia e aplikimit sekuestrohet dhe kalon tërësisht në favor të shtetit, nëse Autoriteti konstaton se: (i) aplikuesi në aplikimin e tij ka deklaruar të dhëna të rreme; (ii) aplikuesi nuk paguan tërësisht tarifën për marrjen e licencës, brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti në përputhje me këtë dokument; (iii) aplikuesi tërhiqet nga kërkesa për shqyrtim të aplikimit të tij pasi ky i fundit është paraqitur; (iv) nuk paguan tërësisht në afat dhe shumë, garancinë e fituesit, sipas përcaktimeve të legjislacionit për lojërat e fatit; (v) nuk paguan shpenzimet për publikimin dhe konsulencën. Në këtë rast Autoriteti sekuestron nga shuma e garancisë, shumën e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të publikimit dhe konsulencës të cituara në pikën 1.5 të këtij dokumenti.</p> <p>Nëse aplikuesi paraqitet në formën e një bashkimi të përkohshëm, garancia e aplikimit duhet të jetë në emër të të gjithë anëtarëve të bashkimit.</p>
Të dhënat shoqëruese	Dokumentet/formularët e kërkuar
<p>KK.7: Aplikuesi, ose nëse aplikuesi është bashkim i përkohshëm, të gjithë anëtarët e bashkimit duhet të paraqesin të dhëna për organet drejtuese të tyre.</p>	<p>Aplikuesi, ose nëse aplikuesi është bashkim i përkohshëm të gjithë anëtarët e bashkimit, duhet të paraqesin aktet e themelit dhe/ose statutet e tyre, së bashku me certifikatën nga organi që mban regjistrin tregtar në vend, ku evidentohen emrat e anëtarëve të organeve drejtuese.</p>
<p>KK.8: Aplikuesi, ose nëse aplikuesi është bashkim i përkohshëm, të gjithë anëtarët e bashkimit duhet të paraqesin të dhëna për aksionarët e tyre.</p>	<p>Aplikuesi, ose nëse aplikuesi është bashkim i përkohshëm të gjithë anëtarët e bashkimit, duhet të paraqesin të dhëna për certifikatën e lëshuar nga organi që mban regjistrin tregtar, ku evidentohen emrat e aksionarëve të tyre dhe përqindjen që ata zotërojnë në kompani dhe evidentimin e aksionarëve që zotërojnë të drejta të veçanta.</p> <p>Për aksionarët që zotërojnë paketën kryesore të aksioneve, duhet të paraqiten të dhënat personale.</p> <p>Nëse aplikuesi zotërohet nga një shoqëri, të dhënat e kërkuara më sipër duhet të paraqiten dhe për shoqërinë që zotëron aksionet dhe aksionarët e kësaj të fundit, deri tek aksionari që zotëron kontrollin e shoqërisë/shoqërive që kontrollojnë shoqëritë që zotërojnë aksionet e aplikuesit.</p>
<p>KK.9: Aplikuesi duhet të paraqesë të dhëna financiare për kryerjen e biznesit për aksionarët e aplikuesit, ose nëse aplikuesi është bashkim i përkohshëm, për aksionarët e anëtarëve të bashkimit. Në rastin kur aplikuesi është bashkim i përkohshëm, si kriter kualifikues, secila prej shoqërive duhet të përmbushë të paktën 30 % të kërkesave për kapacitetin ekonomik dhe financiar.</p>	<p>Aplikuesi duhet të paraqesë pasqyra financiare të audituara, të certifikuara nga ekspert(ë) kontabël, për tri (3) vitet e plota financiare të fundit, aty ku është e mundur, duke përfshirë bilancet e konsoliduara, pasqyrat e të ardhurave, pasqyrat e qarkullimit të parasë dhe shënimet shoqëruese për aksionarët e tij ose nëse aplikuesi është një bashkim i përkohshëm, për të gjithë aksionarët e anëtarëve të tij.</p>



Kriteret kualifikuese	Dokumentet/formularët e kërkuar
KK.10: Aplikuesi ose nëse aplikuesi është bashkim i përkohshëm, të gjithë anëtarët e bashkimit, duhet të kenë shlyer detyrimet tatimore ndaj shtetit.	Aplikuesi ose nëse aplikuesi është bashkim i përkohshëm, të gjithë anëtarët e bashkimit, duhet të paraqesin vërtetime nga organet tatimore se kanë shlyer detyrimet ndaj organeve tatimore.
KK.11: Aplikuesi ose nëse aplikuesi është bashkim i përkohshëm, anëtari kryesues i bashkimit duhet të ketë staf të kualifikuar për ushtrimin e veprimtarisë së lojërave të fatit dhe jo më pak se 300 të punësuar.	Aplikuesi ose nëse aplikuesi është bashkim i përkohshëm, anëtari kryesues i bashkimit, duhet të paraqesë listën e punonjësve që ka dhe eksperiencën e secilit prej tyre në fushën e veprimtarisë së lojërave të fatit.
KK.12: Aplikuesi duhet të paraqesë draftregulloren dhe mënyrën e funksionimit të lojës për të cilën kërkon të licencohet.	Rregullorja duhet të jetë e detajuar sipas kërkesave të ligjit dhe e nënshkruar në çdo faqe nga personi i autorizuar për të paraqitur ofertën.
KK.13: Aplikuesi duhet të paraqesë biznes planin e zhvillimitin e veprimtarisë lotari kombëtare.	Biznesplanin duhet të jetë i detajuar dhe të tregojë me detaje mënyrën sesi aplikuesi mendon ta zhvillojë veprimtarinë e tij në të paktën 5 vitet e ardhshme, përfshirë dhe mënyrën e financimit të kësaj veprimtarie.

Në rastin kur aplikanti është bashkim i përkohshëm, atëherë të paktën një nga anëtarët e bashkimit duhet të plotësojë 100% të kriterëve të domosdoshme për kualifikim sipas fazës I. Anëtari që plotëson 100% të kriterëve, duhet të zotërojë të paktën 50 % të të drejtave të bashkimit.

Aplikuesi, ose nëse aplikuesi është bashkim i përkohshëm, të paktën anëtari kryesues, për të plotësuar kriteret e kualifikimit, ka të drejtë të paraqesë evidencë aktivitetesh të ndërmarra nga “Shoqëria mëmë” (siç përcaktohet më poshtë):

“Shoqëri mëmë”, në kontekstin e këtushëm, quhet çdo subjekt që kontrollon aplikuesin ose anëtarin kryesues të bashkimit të përkohshëm. Nga ana tjetër përkufizimi “kontroll” do të thotë pasja e shumicës së votave dhe e shumicës së përfaqësimit në asamblenë e përgjithshme (ose organe të tjera të ngjashme).

Në rast se aplikuesi paraqet eksperiencat teknike dhe financiare të “Shoqërisë mëmë”, atëherë kjo e fundit do të jetë përgjegjëse solidare me aplikuesin për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga licencimi. Garancia në këtë rast jepet nga organet drejtuese të “Shoqërisë mëmë” që kanë të drejtë të angazhojnë këtë të fundit në të tilla marrëdhënie. Forma dhe përmbajtja e kësaj garancie duhet të jenë të kënaqshme për Autoritetin.

2.3 Dokumentet që dëshmojnë plotësimin e kriterëve të fazës I

Kërkesa të tjera për t’u plotësuar nga aplikantët në fazën e kualifikimit

2.3.1 Kërkesa të lidhura me zotësinë juridike të aplikantëve:

a) regjistrimi si person juridik, i cili të dëshmohet nëpërmjet një ekstrakti të regjistrimit tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;

b) të dhëna personale për aksionarët kryesorë të shoqërisë, që kontrollojnë paketën kryesore të aksioneve dhe pronarët kryesorë përfitues;

c) të dhëna për organet drejtuese të aplikantit;

d) numri i identifikimit (NIPT), si dhe një kopje të noterizuar të lejes për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit;

e) deklaratë të lëshuar nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë, në të cilën deklarohet se shoqëria nuk është në proces falimentimi apo likuidimi;

ë) deklaratë e lëshuar nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë në lidhje me shlyerjen e detyrimeve me administratën tatimore;

f) deklaratë të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë në të cilën deklarohet se shoqëria nuk është dënuar për shkelje penale të lidhura me veprimtarinë profesionale;

g) vetëdeklarimin nga përfaqësuesit në organet drejtuese të shoqërisë se nuk janë në ndjekje penale dhe se nuk janë dënuar për shkelje penale të lidhura me veprimtarinë profesionale;

gj) deklaratë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, në të cilën deklarohet se kapitalet/asetet e subjektit nuk janë duke u vlerësuar apo ekzekutuar nga zyra e përmbarimit apo për të cilat nuk ekziston një urdhër sekuestroje, bllokim dhe të tjera të ngjashme, lëshuar nga zyra e përmbarimit;

h) një marrëveshje paraprake, të paktën me njërën nga bankat, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, për arkëtimin, depozitim dhe transferimin e pagesave;

i) planbiznesi për zhvillimin e veprimtarisë lotari kombëtare;

j) dokumentacioni që vërteton eksperiencën prej të paktën 15 vitesh në fushën e lojërave të fatit, si dhe prej të paktën 5 vitesh nëpërmjet platformës së internetit;

k) dokumentacion që vërteton se aplikuesi ka personel të kualifikuar dhe të paktën 300 të punësuar në momentin e aplikimit.

Për shoqëritë e huaja, të dhënat e përcaktuara nga shkronjat “a” deri në “gj” do të dokumentohen nga vërtetimet e lëshuara nga organet kompetente përkatëse për lëshimin e tyre në vendin e tyre të origjinës. Me përjashtim të vërtetimit të parashikuar në shkronjën “a”, shoqëritë e huaja, në shtetet e të cilëve nuk mund të lëshohen dokumentet e parashikuara në shkronjat e tjera, lejohen t’i paraqesin ato në formën e deklaratave me shkrim, nën përgjegjësinë e tyre të plotë. Çdo e dhënë e deklaruar e që rezulton e rreme, përbën një kusht të mjaftueshëm për të skualifikuar aplikantin. Sipas rastit, Autoriteti do të investigojë nëse këto vërtetime lëshohen apo jo nga institucionet përkatëse në vendin e origjinës, dhe në rast se konstaton zyrtarisht se në shtetin e origjinës ekziston një institucion i cili mund të lëshojë një vërtetim të tillë, të paraqitur nga aplikanti i huaj në formën e vetëdeklarimit atëherë Komisioni do ta quajë të pavlefshëm dokumentin vetëdeklarues të paraqitur dhe aplikanti për këtë shkak skualifikohet.

Kriteret e mësipërme do të konsiderohen të përmbushura vetëm nëse dokumentet e paraqitura janë origjinale, fotokopje të noterizuara, ose në një formë tjetër në të cilën ato lëshohen nga organi kompetent, si dhe me apostil, në rastin kur bëhet fjalë për dokumente të lëshuara nga autoritete apo institucione të një shteti tjetër. Përveç NIPT-it, kriteret e përcaktuara më lart duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve të lëshuara jo më parë se tre muaj nga dita e dorëzimit të ofertës.

Dokumentet e paraqitura nga çdo aplikant i huaj ose anëtar i huaj i një bashkimi të përkohshëm shoqërisht të lëshuara nga një vend i ndryshëm nga ai i Republikës së Shqipërisë duhet të jenë të legalizuara ose të mbajnë vulën apostile në përputhje me ligjin nr.9060, datë 8.5.2003.

2.4 Pjesa III – Dokumentet dhe kërkesat për bashkimet e përkohshme

Nëse aplikuesi është bashkimi i përkohshëm, duhet që çdo anëtar i tij të autorizojë me prokurë noteriale lëshuar në përputhje me seksionin 2.6 njërin anëtar si kryesues për të vepruar në emër të tyre. Anëtari kryesues merr përsipër që bashkimi i përkohshëm të mos ndryshojë përbërjen e bashkimit të përkohshëm, pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit.

Aplikuesi që paraqitet si bashkim i përkohshëm duhet të dorëzojë, sipas pjesës III të aplikimit, një deklaratë me shkrim, në formën e një letre të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i secilit prej shoqërive të bashkimit të përkohshëm, ku:

a) konfirmon se merr pjesë në bashkimin e përkohshëm; dhe

b) emëron anëtarin që do të veprojë si kryesues i bashkimit të përkohshëm në emër të të gjithë anëtarëve.

2.5 Pjesa IV – Prokura

Çdo aplikues (ose anëtar i bashkimit të përkohshëm, kur aplikuesi është i tillë) duhet të dorëzojë, në përputhje me pjesën IV të aplikimit, një prokurë noteriale, sipas formularit të specifikuar në dokumentet e tenderit, që tregon se personi (personat) që kanë nënshkruar aplikimin kanë të drejtën e nënshkrimit.



2.6 Pjesa V – Materiale të botuara

Nëse aplikuesi dëshiron të dorëzojë materiale të botuara (si p.sh. broshura) për veprimtarinë e tij, ato duhet të përfshihen vetëm në pjesën V të aplikimit dhe të jenë të ndara nga pjesa tjetër e dokumenteve, brenda zarfit përkatës.

2.7 Sqarime

Aplikuesi që kërkon sqarime rreth udhëzimeve, kritereve kualifikuese ose për ndonjë kërkesë tjetër të përcaktuar, mund të njoftojë me shkrim Autoritetin.

2.8 Formatimi dhe nënshkrimi i aplikimit

a) Çdo aplikues duhet të përgatisë dhe dorëzojë origjinalin e aplikimit dhe një numër kopjesh të përcaktuara nga Autoriteti, duke vënë qartazi mbi secilën prej tyre shënimin “Origjinal”, “Kopja nr.1”, “Kopja nr.2” etj., përkatësisht. Në rast mospërputhjeje midis kopjeve dhe origjinalit, do të merret për bazë origjinali.

b) Origjinali dhe të gjitha kopjet e aplikimit, pra dokumentet e renditura në seksionin 2.2, duhet të jenë të shtypura ose të shkruara me bojë që nuk fshihet. Personi ose personat me të drejtë nënshkrimi duhet të nënshkruajnë aplikimin duke:

i) nënshkruar origjinalin e aplikimit; dhe

ii) shënuar inicialet në secilën faqe të origjinalit të aplikimit, me përjashtim të materialeve të botuara.

c) Aplikimi nuk duhet të ketë ndryshime, fshirje apo shtesa, me përjashtim të rastit kur korrigjimet nënshkruhen nga personi apo personat me të drejtë nënshkrimi të aplikimit.

3. Dorëzimi i aplikimit

Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve, i emëruar në përputhje me këtë dokument, vlerëson respektimin e kërkesave nga aplikantët dhe përmbushjen e kritereve kualifikuese të parashikuara në fazën I dhe deklaron listën e aplikuesve që kanë të drejtë të kalojnë në fazën II të garës.

3.1 Vulosja dhe vënia e shenjave mbi aplikimin

3.1.1 Aplikuesi do të mbyllë origjinalin e aplikimit dhe secilën kopje në zarfe të veçanta. Secili zarf do të ketë dokumentet e specifikuar në pikën 2.2 të këtij dokumenti dhe do të shkruajë mbi zarfe “aplikimi-origjinal” dhe “aplikimi-kopje” (të gjitha të shënuara siç kërkohet këtu). Zarfet do të vulozen dhe do të futen në një zarf tjetër më të madh, i cili, gjithashtu, vulozet. Zarfet e brendshme dhe të jashtme do t’i drejtohen titullarit të Autoritetit.

Ministria e Financave

Bulevardi Dëshmorët e Kombit, nr.4

Tiranë, Republika e Shqipërisë

dhe mbi to do të shkruhet:

“Aplikim për licencë për lotari, të mos hapet përpara datës __ ora __”.

3.1.2 Zarfet e brendshme do të kenë të shënuar secili emrin dhe adresën e aplikuesit (në rastin e bashkimit të përkohshëm, emri dhe adresat e anëtarit kryesues).

3.1.3 Nëse zarfi i jashtëm nuk është shënuar dhe vulosur siç kërkohet në pikën 3.1.1 të këtij dokumenti, Komisioni për Vlerësimin e Aplikimeve nuk ka asnjë përgjegjësi për ndonjë vendosje/shkrim gabim të zarfeve apo hapje të parakohshme. Nëse në zarfin e jashtëm është shkruar emri i ofertuesit Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve nuk ka përgjegjësi për humbjen e anonimitetit të aplikuesit, sidoqoftë, vendosja e identitetit të aplikuesit mbi zarfin e jashtëm nuk është shkak për mosshqyrtimin e kërkesës për parakualifikim.

3.1.4 Aplikimi duhet të dorëzohet në datën dhe orën e përcaktuar në dokumentet e garës. Çdo aplikim i cili është dorëzuar më vonë se data dhe ora e përcaktuar në dokumentet e garës, nuk do të pranohet. Ai do t’i kthehet i pahapur dërguesit.

Shqyrtimi i kritereve të kualifikimit bazohet në metodën “kalon”/“nuk kalon”.

Vetëm ofertat që kanë plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara do të konsiderohen të përgjegjshme dhe do të kualifikohen.

Çdo aplikim që nuk i përmbush kërkesat e parashtruara do të refuzohet nga Komisioni dhe as nuk do të merret në konsideratë për shqyrtim në një kohë tjetër.

Autoriteti ka të drejtë të verifikojë çdo informacion dhe dokument të dhënë nga aplikuesi dhe kur aplikuesi është bashkim i përkohshëm për të gjithë anëtarët e bashkimit. Për këtë aplikuesi përfshin në aplikimin e tij një autorizim që autorizon Autoritetin për të bërë, pa asnjë kufizim, verifikimin e dokumentacionit dhe/ose informacionit të dhënë në aplikim. Dështimi i aplikuesit për të dhënë një autorizim të tillë, do të sjellë refuzimin e aplikimit.

Autoriteti ka të drejtë t'u drejtohet institucioneve të vendit apo të huaja, për të konfirmuar vërtetësinë e dokumentacionit, si dhe besueshmërinë e të dhënave në lidhje me kapitalet e aplikuesit apo të personave që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë e kontrollojnë aplikuesin.

3.2 Vlerësimi i aplikimit

Komisioni do të vlerësojë imtësisht aplikimin, për të përcaktuar nëse përmbush kriteret e kualifikimit duke pasur parasysh rregullin e mëposhtëm:

Vlerësimi i kriterëve dhe kërkesave të kualifikimit të specifikuar në pikën 2 të këtij dokumenti, bazohen në metodën: “kalon”/“nuk kalon”, për secilin kriter mbështetur te dokumentacioni i dorëzuar për secilin kriter.

Aplikimi që plotëson të gjitha kriteret dhe kërkesat kualifikuese, të specifikuar në pikën 2 të këtij dokumenti, do të quhet “aplikim i përgjegjshëm”.

Aplikimi që nuk plotëson qoftë edhe një kriter të vetëm të specifikuar në pikën 2 dhe kërkesat e tjera të këtij vendimi, do të quhet “Aplikim i refuzuar”.

Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit nga ky Komision, për pranimin apo refuzimin e aplikimeve, njofton të gjithë aplikuesit për këtë vendim.

Aplikuesit kanë të drejtë të ankimojnë vendimin e Komisionit për refuzimin e aplikimit te titullari i autoritetit, brenda 5 ditëve nga data që kanë marrë njoftim, apo nga data kur ai duhej të kishte marrë njoftim. Titullari i Autoritetit, brenda 30 ditëve nga marrja e ankimit, njofton aplikuesin në lidhje me vendimin për ankimin e tij, si dhe shkaqet për refuzimin apo pranimin e vendimit.

4. Përfundimi i vlerësimit

Brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit ligjor të njoftimit apo nëse ka pasur një ankim, brenda 5 ditëve nga vendimi përfundimtar i Autoritetit, Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve njofton aplikuesit, aplikimi i të cilëve është vlerësuar si “Aplikim i përgjegjshëm”, për përmbylljen e fazës I. Faza II zhvillohet nëse së paku 1 aplikim konsiderohet si “Aplikim i pranuar”. Gjatë periudhës midis përfundimit të fazës I dhe deri në organizimin e fazës II, Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve merr masa për ruajtjen e dokumentacionit.

5. Faza II: Përzgjedhja e fituesit

5.1 Vlerësimi i aplikantëve që kanë kaluar fazën I kualifikuese

Në datën dhe orën e njoftuar nga Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve, fillon shqyrtimin e dokumentacionit përzgjedhës i cili vlerësohet si më poshtë:

I. Struktura e aplikantit dhe gjendja financiare 15 %

a) Përvoja e aplikantit (llojet dhe numrat e licencave dhe kohëzgjatja) dhe portofoli aktual i produktit;

b) gjendja financiare:

- Raporte financiare të audituara dhe të publikuara të tri viteve të fundit;

- Kredibiliteti financiar (fitimi, raporti i kapitalit, koha e shlyerjes së borxhit, rezervat, huat);



c) Analizë e detajuar e strukturës së organizimit, kualifikimit dhe menaxhimit të të punësuarve;

d) Struktura e pronësisë;

e) Siguria e IT (WLA SCS:2006), shpjegimi;

f) Auditimi i brendshëm dhe politika e mbrojtjes së të dhënave;

g) Politikë e përgjegjshmërisë sociale të korporatës dhe modelit të drejtimit të saj.

II. Përputhja me politikat rregullatore 35%

1. Loja me përgjegjshmëri

Aplikantët e kualifikuar në fazën I duhet të sigurojnë një plan për implementimin në Shqipëri nëpërmjet aktiviteteve përgjegjëse të një politike të lojërave të përgjegjshme, në përputhje me standardet e WLA dhe të jenë të pajisur me certifikatë së paku të nivelit të katërt, ose me certifikatën EL (European Lotteries), të lëshuara në juridiksione të tjera.

Aplikanti paraqet informacionin e mëposhtëm:

a) Informacioni dhe komunikimi

Reklamim dhe marketing i përgjegjshëm

Aplikantët nuk do të reklamojnë direkt te grupet e cenueshme (duke konsideruar moshën, gjendjen shoqërore dhe varësinë ndaj lojërave të fatit). Aplikuesit do të adoptojnë një “kod reklamimi dhe marketingu” që të garantojë se aktivitetet e reklamimit dhe të promovimit të shitjeve nuk nxitin të mitur ose atyre me probleme në luajtje dhe që nuk i japin lojtarit informacione keqorientuese si p.sh., përshtypje të rreme të koeficienteve të fitimit.

Edukimi i lojtarëve, mbrojtja e të miturve dhe parandalimi i varësisë

Aplikuesit duhet të përfshijnë çështje në informacionin e përcaktuar për lojtarët (përfshirë këtu edhe platformën e internetit (kanalet në distancë). Për shembull, informacion i detajuar mbi koeficientet e fitimit për secilën lojë që lejon njerëzit të vlerësojnë rrezikun dhe përfitimin nga e luajtura.

Aplikuesve do t’u ndalohet t’u shesin minorenëve dhe të ndërtojnë një program për ta vënë në zbatim këtë përmes rrjetit të tyre të agjentit të shitjeve.

Vetëdija e klientëve do të ngrihet nëpërmjet informimit (p.sh. dosjet, faqja e internetit). Bashkëpunimi me institucionet e këshillimit dhe të trajtimit do të jetë pjesë e programit të kompanisë.

b) Trajnimi i punonjësve

Aplikuesit duhet t’u japin të gjithë punonjësve informacion për programet e tyre të lojës me përgjegjësi përmes kanaleve të posaçme të komunikimit. Aplikuesit duhet të sigurojnë që të mbahet një nivel i përshtatshëm ndërgjegjësimit për lojën me përgjegjësi gjatë gjithë organizimit, në mënyrë që loja e përgjegjshme të kthehet në një pjesë integrale të operimeve ditore.

c) Programet e agjentit të shitjeve

Të gjithë agjentëve të shitjeve do t’u vihen në dispozicion materialet informuese (p.sh. broshurat, fletëpalosjet), në mënyrë që të risin ndërgjegjësimin për lojën me përgjegjësi dhe t’i edukojnë ata për çështje lidhur me problemin e të luajturit. Përpara se agjentët e rinj të shitjeve të lejohen t’u shesin produktet aplikuesve, atyre duhet t’u sigurohet trajnimi, përveç të tjerash për lojën me përgjegjësi.

d) Kanalet e lojërave të drejtuara në distancë

Aplikuesit duhet të sigurojnë që platformat e tyre të lojërave të fatit të kontrollohesh në distancë (internet, TV, pajisje të lëvizshme) të përfshijnë:

- Sistemin e verifikimit të moshës;

- Limite të kontrollohesh nga klienti dhe/ose limite të paracaktuara të sistemit për lojë, shpenzime dhe/ose humbje;

- Mundësitë e vetëpërgjashtimit për lojtarët;

- Kontrollin real nëpërmjet ekranit të lojës (p.sh. orën e sesionit, mundësi ndërprerjeje të lojës, si me vetëvendosje, ashtu edhe nëpërmjet sistemeve kontrolluese/paralajmëruese për afrimin ndaj limiteve të parapërcaktuara nga vetë lojtari, ndërprerje/pushime midis fazave të lojës);

- Elementet e kontrollit të mbrojtjes së të dhënave;

- Vlera e basteve duhet të jetë e shfaqur;

- Lidhje/adresa në çdo faqe interneti për informacion për të luajtur me përgjegjësi, politikat e aplikuesit mbi lojën me përgjegjësi dhe burimet e këshillimit dhe mbështetjes (p.sh. numrat e asistencës së lojtarëve).

2. Bashkëpunimi me autoritetet

Aplikantët duhet të vënë në dispozicion të gjitha dokumentet e kërkuara nga autoritetet në çdo kohë dhe t'u përgjigjen në një mënyrë të arsyeshme të gjitha kërkesave të bëra nga autoriteti.

Aplikantët do të emërojnë një person përgjegjës për përputhshmërinë ligjore dhe kuadrin rregullator, apo të kenë emëruar një person të tillë në zyrat qendrore sa herë që të kërkohet.

3. Lufta kundër pastrimit të parave

Pavarësisht se direktiva e tretë e BE-së kundër pastrimit të parave nuk zbatohet te lotaritë, aplikuesit duhet të mundësojnë politikën dhe planin e tyre në funksion të kësaj çështjeje. Aplikantët duhet të depozitojnë vërtetime nga institucione kompetente të njohura ndërkombëtare që dëshmojnë angazhimin e garuesit në luftën kundër pastrimit të parave dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare në këtë fushë.

III. Plani i biznesit dhe parashikimet financiare 25%

Aplikantët duhet të vënë në dispozicion një plan të plotë dhe të detajuar biznesi për 5 vitet e para, duke përfshirë një analizë të arsyetuar të rendimentit të të ardhurave fiskale të pritura për buxhetin e shtetit dhe investimin e planifikuar në Shqipëri bazuar në njohuri të provuara në tregun shqiptar të lojërave të fatit (në mënyrë të veçantë në tregun e lotarive), të dokumentuar për shembull në studimin e tregut.

IV. Strategjia e zhvillimit të tregut 25%

Ndonëse pjesë e planit të biznesit, aplikuesit duhet të sigurojnë detaje për çështjet e mëposhtme:

1. Planifikimin e implementimit të projektit (përfshirë stafin e dedikuar dhe eksperiencën) dhe planin e lojërave (tipat e lojërave, numrin e lojërave, frekuencën e shorteve).

2. Skema e shpërndarjes dhe implementimin në faza.

3. Planin e marketingut dhe të reklamimit (llojet e marketingut dhe të reklamimit, planifikimin dhe buxhetin, stafin e dedikuar).

4. Arkitektura e IT dhe kohëzgjatja e implementimit në treg (duke përfshirë kontraktimin e furnitorëve potencial dhe stafit).

5. Lotaritë e mundshme ndërkombëtare (njohuria dhe eksperiencia me lojërat e lotarisë ndërkombëtare ekzistuese ndonëse jo e kërkuar, duhet të përmendet).

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përgatit raportin përfundimtar të vlerësimit dhe njofton renditjen. Ky njoftim publikohet dhe në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave.

Aplikuesit kanë të drejtën e ankimit për këtë vendim, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes, te titullari i Autoritetit, i cili merr vendim brenda 30 ditëve nga paraqitja e kësaj ankese.

Në përfundim të kësaj procedure, titullari i Autoritetit bën shpalljen e fituesit, si dhe fton aplikuesin e shpallur fitues të plotësojë kushtet e parashikuara nga legjislacioni për marrjen e licencës.

5.2 Shpallja e fituesit

Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve shpall listën e pjesëmarrësve në fazën II, duke filluar renditjen nga aplikanti, që ka marrë numrin më të madh të pikëve. Kandidati, që ka marrë numrin më të madh të pikëve, shpallet fitues.



Kur aplikanti, i renditur i pari në listë, nuk vazhdon procedurat për marrjen e licencës, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së tij fitues, skualifikohet dhe shpallet fitues konkurrenti i renditur i dyti, sipas listës së miratuar.

Me përfundimin e afatit për paraqitjen e ankesave, për rastet e aplikantëve të huaj, Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve miraton dhënien e licencës për lotari kombëtare, pasi aplikanti i huaj, i shpallur i pari në listë, brenda 30 ditëve regjistron një person juridik shqiptar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

5.3 Licencimi

Brenda 5 ditëve nga momenti kur Banka ka konfirmuar pagesën, Autoriteti përcjell praktikën për miratim në Kuvend.

Licenca jepet për një afat 10-vjeçar nga dita e organizimit të lojës I.

Loja I duhet të organizohet jo më vonë se tetë muaj nga miratimi i licencës nga Kuvendi.

Aplikanti i përzgjedhur fitues në garën për marrjen e licencës për lotarinë kombëtare, paguan, në njëerën nga bankat e nivelit të dytë, shumën prej 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë, jo më vonë se 14 ditë kalendarike nga marrja e licencës, por në çdo rast para dërgimit të licencës për miratim në Kuvend. Kjo shumë kalon në buxhetin e shtetit.

Nëse aplikuesi është person juridik i huaj dhe/ose bashkim i përkohshëm, ai duhet të dorëzojë dokumentacionin që vërteton krijimin e shoqërisë që do të marrë licencën, sipas parashikimeve të shkronjës “b” të nenit 30 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar.

Nëse aplikuesi është bashkim i përkohshëm, ai nuk duhet të ndryshojë strukturën e bashkimit të përkohshëm pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit.

Nëse aplikuesi është person juridik i huaj dhe/ose bashkim i përkohshëm i shoqërive dhe konform paragrafit “a” më sipër do të krijojë një person juridik për efekt të licencimit, atëherë pronësia e aksioneve të personit juridik krijuar sipas paragrafit “a” më sipër dhe çdo ndryshim në pronësinë e aplikuesit dhe/ose aksionarëve të tij që do të sillte në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë një ndryshim në kontrollin e të licencuarit në krahasim me momentin kur aplikimi është paraqitur, duhet të bëhet me pëlqimin paraprak të Ministrisë së Financave. Çdo shkelje e këtij rregulli, i cili është i aplikueshëm si për personat juridikë të krijuar për efekt të paragrafit “a” më sipër, si dhe për çdo aplikues tjetër që është licencuar sipas këtij vendimi, përbën kusht për revokimin e licencës nga Autoriteti.

6. Komisioni i Vlerësimit të Aplikimit

Komisioni i Vlerësimit të Aplikimit, ngrihet me urdhër të Ministrit të Financave dhe përbëhet nga 5 anëtarë si më poshtë;

- | | |
|---|----------|
| 1. Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Financave | Kryetar |
| 2. DPPP | 1 Anëtar |
| 3. NJMLF | 1 Anëtar |
| 4. Përfaqësues i Ministrisë së Brendshme | 1 Anëtar |
| 5. Përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë | 1 Anëtar |

Kryetari i Komisionit cakton Sekretarinë e Komisionit, e cila merr pjesë pa të drejtë vote në mbledhjet e Komisionit dhe është përgjegjëse për protokollimin e mbledhjeve vendimeve dhe në përgjithësi të korrespondencës me Aplikuesit.

Vendimet e Komisionit janë të vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij dhe për një vendim të caktuar kanë votuar pro të paktën 3 anëtarë.

Votimi është i hapur dhe nuk lejohet abstenimi. Anëtarët që votojnë kundër, duhet të paraqesin shkaqet e votimit kundër.

7. Pezullimi dhe revokimi i licencës

Përveç sa parashikohet shprehimisht nga ligji nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, titullari i Autoritetit revokon licencën e dhënë në rast se vërtetohet se i licencuari, në fazën e aplikimit apo në vijim ka paraqitur një informacion jo të saktë dhe/ose të rremë.

Titullari i Autoritetit pezullon licencën në rast se i licencuari rezulton të mos përmbushë më ndonjë nga kushtet e përcaktuara nga legjislacioni për lojërat e fatit apo për shkaqe të tjera për të cilat kërkohet ndryshim i rregulloreve të miratuara nga Autoriteti.

Në urdhrin për pezullim i cili nuk mund të jetë më i madh se 3 muaj, titullari i Autoritetit përcakton kushtet që duhet të plotësojë i licencuari për rregullimin e situatës.

Nëse, edhe pas kalimit të afatit prej 3 muajsh, gjendja nuk është rregulluar apo rregulloret nuk u janë përshtatur kërkesave të Autoritetit, atëherë Autoriteti vendos revokimin e licencës.

VENDIM

Nr.26, datë 11.1.2012

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 248, DATË 27.4.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 19 të ligjit nr.9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.248, datë 27.4.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas shkronjës “m” të pikës 3 shtohen shkronjat “n” dhe “nj”, me këtë përmbajtje:

“n) zhvillon dhe ofron shërbimet e përqendruara elektronike për administratën publike;

nj) krijon dhe administron infrastrukturën qeveritare të Çelësit Publik (PKI).”.

b) Shprehja “...Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin...” zëvendësohet me “...Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit...”;

c) Shprehja “...në fushën e komunikimeve elektronike...” zëvendësohet me “... në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare...”.

2. Me garancinë financiare si institucion qeveritar, Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit siguron pajtueshmërinë me nenin 19 të ligjit nr.9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik.”.

3. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.27, datë 11.1.2012

PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË FEMRAVE NGA GRUPET E VEÇANTA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punëdhënësi, që punëson me kontratë, me kohëzgjatje njëvjeçare, punëkërkues të papunë femra nga grupet e veçanta, mund të përfitojë:

a) një financim për një vit, në masën 100 për qind, të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të pjesës së punëdhënësit;

b) një financim për katër muaj, në masën 100 për qind, të pagës minimale në shkallë vendi, në muajt e pestë e të gjashtë dhe të njëmbëdhjetë e të dymbëdhjetë të kontratës;

c) punësimin deri në 100 për qind të numrit aktual mesatar të të siguruarve (të 3 (tre) muajve të fundit përpara aplikimit), për mikrondërmarrjet, dhe deri në 50 për qind, për ndërmarrjet e tjera.

2. Femra nga grupet e veçanta janë:

a) femra të papuna për një periudhë afatgjatë (të regjistruara, si punëkërkuese të papuna prej më shumë se një viti);

b) femra që përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura;

c) femra të trafikuar;

ç) femra mbi 50 vjeç;

d) femra rome;

dh) femra me aftësi të kufizuara;

e) vajza nëna;

ë) femra të divorcuara me probleme sociale;

f) femra që kthehen nga emigracioni, me probleme ekonomike.

3. Punëdhënësi, që aplikon për programin e punësimit, nuk duhet të ketë shkelur në të kaluarën legjislacionin e punës, verifikuar nga Inspektorati i Punës, si dhe duhet të ketë derdhur rregullisht tatimet e sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, veçanërisht për vitin e fundit.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit apo zyrat rajonale të punësimit bëjnë njoftimin në Buletinin e Njoftimeve Publike, çdo vit, për fondin e vënë në dispozicion dhe kriteret e përfitimit nga ky program.

5. Për të përfituar nga ky program, punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës përkatëse të punësimit, ku ai e zhvillon veprimtarinë, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Vendimin e gjykatës për regjistrimin si person juridik ose vendimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;

b) Numrin e identifikimit të personit të tatuësëm (NIPT-in);

c) Vërtetimin për shlyerjen e kontributeve për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të lëshuara nga organet e sigurimeve shoqërore, për aq kohë sa ushtron veprimtarinë, por jo më gjatë se për një periudhë kohore njëvjeçare, nga çasti i aplikimit;

ç) Numrin e llogarisë bankare;

d) Vërtetimin nga dega e tatim-taksave, ku personi juridik ushtron veprimtarinë, për shlyerjen e detyrimeve tatimore për aq kohë sa kryen veprimtarinë, por jo më gjatë se për një periudhë kohore njëvjeçare, nga çasti i aplikimit;

dh) Informacion për:

i) numrin e fuqisë punëtore;

ii) listën emërore të të siguruarve;

iii) llojin e veprimtarisë, që kryen;

iv) nivelin e pagës së dhënë, për çdo person;

v) planbiznesin për shtimin e fuqisë punëtore.

6. Punëdhënësi, në bashkëpunim me zyrën përkatëse të punësimit, dhe në mbështetje të të dhënave e të dokumentacionit, të përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi, plotëson formularin përkatës, sipas modelit të miratuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

7. Inspektorati rajonal/vendor i punës bën verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, sipas kërkesave të përcaktuara në shkronjën “dh” të pikës 5 të këtij vendimi, dhe shprehet, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, për vërtetësinë dhe korrektësinë e këtij dokumentacioni.

8. Zyra përkatëse e punësimit ia paraqet këshillit vendor tripalësh të ngritur pranë saj projektet që kërkohen të zbatohen aty, ku ajo ushtron veprimtarinë, i cili, pasi shqyrton dhe vlerëson dobinë social-ekonomike të projekteve të paraqitura, i miraton ato në parim.

9. Pas miratimit, në parim, të projekteve në këshillin vendor tripalësh, zyra përkatëse e punësimit i dërgon, për miratim, si më poshtë vijon:

a) Zyra vendore e punësimit, sipas rastit, ia dërgon zyrës rajonale të punësimit ose Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

b) Zyra rajonale e punësimit miraton projektet, kur numri i të punësuarve dhe i atyre, që kërkohen për t'u punësuar nga punëdhënësi, është jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) persona.

c) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit miraton projektet kur numri i të punësuarve dhe i atyre, që kërkohen për t'u punësuar nga punëdhënësi, është më shumë se 50 (pesëdhjetë) persona.

10. Për zbatimin e pikës 9 të këtij vendimi, në zyrat rajonale të punësimit dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit ngrihen komisionet e miratimit të projekteve, me jo më pak se 5 (pesë) persona. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të punës, si dhe përbërja e komisioneve përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Këshilli Administrativ Tripalësh i Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

11. Komisioni i miratimit të projekteve në zyrën rajonale të punësimit, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës për aplikim nga punëdhënësi, vendos miratimin ose jo të projektit. Komisioni i miratimit të projekteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, vendos miratimin ose jo të projektit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës për aplikim nga punëdhënësi.

12. Zyra e punësimit propozon më shumë kandidatura punëkërkuesish që plotësojnë kriteret për një vend të kërkuar nga punëdhënësi. Ky i fundit përzgjedh kandidatin më të përshtatshëm.

13. Punëkërkuesit e papunë, që kundërshtojnë të marrin pjesë në këtë program, hiqen nga lista e punëkërkuesve të papunë.

14. Ndërmjet zyrave përkatëse të punësimit dhe të punëdhënësit nënshkruhet një kontratë, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet, në përputhje me programin për secilën palë. Kontratat lidhen vetëm për vitin buxhetor, për të cilin është miratuar projekti. Për vazhdimin e projektit në vitin pasardhës do të lidhet një kontratë shtesë, në përputhje me fondet e miratuara atë vit.

15. Punëdhënësi dhe punëkërkuesi, si punëmarrës, nënshkruajnë një kontratë individuale pune, në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin e Punës dhe në këtë vendim. Një kopje e kontratës së punës së çdo punëkërkuesi, punëmarrës,



depozitohet në zyrën përkatëse të punësimit, e cila, në bashkëpunim me inspektoratin rajonal/vendor të punës, ndjek zbatimin e kontratës deri në përfundim të projektit.

16. Në rastet kur punëkërkuessi, si punëmarrës, pjesëmarrës në këtë program, largohet përpara afatit të përcaktuar në kontratë brenda gjysmës së parë të zbatimit të kontratës sipas pikës 15 të këtij vendimi për shkaqe të arsyeshme, zëvendësimi bëhet nga zyra përkatëse e punësimit, pas njoftimit nga punëdhënësi dhe vlerësimit të Inspektoratit të Punës për shkaqet e zgjidhjes së kontratës.

17. Financimi sipas pikës 1 të këtij vendimi, ndërpritet në rastin kur punëdhënësi, pas përfitimit të financimit, në zbatim të këtij vendimi, zgjidh, pa shkaqe të arsyeshme, kontratat e punës së punëmarrësve të tjerë, të punësuar pranë tij, të vërtetuar nga Inspektorati Shtetëror i Punës.

18. Nëse punëdhënësi në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme bën zgjidhjen e kontratës së punës për punëkërkuessin e punësuar, sipas përcaktimit të nenit 146 të Kodit të Punës, është i detyruar ta kthejë të gjithë financimin e marrë, për punëkërkuessin e punësuar, që nga data e parë e dhënies së tij, së bashku me interesat, të llogaritura sipas normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë.

19. Kontratat tip, sipas përcaktimeve të dhëna në pikat 14 e 15 të këtij vendimi, hartohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga zyrat përkatëse të punësimit.

20. Shërbimi Kombëtar i Punësimit monitoron ecurinë e programit dhe përgatit raporte vjetore, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, të cilat ia paraqet Ministrin të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrin të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

21. Programi i punësimit të fillojë të zbatohet në vitin 2012 dhe kohëzgjatja e tij të jetë 5 (pesë) vjet.

22. Shërbimi Kombëtar i Punësimit ruan dokumentacionin për skemën deri në 10 (dhjetë) vjet pas dhënies së fundit të ndihmës individuale.

23. Programi vlerësohet nga ekspertë ose organizata të pavarura, që kanë përvojë në këtë fushë dhe njohuri për tregun e punës.

24. Kostoja dhe vlerësimi i këtij programi përballohen nga fondet vjetore të buxhetit të shtetit, zëri "Nxitja e punësimit", miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

25. Vendimi nr.632, datë 18.9.2003 i Këshillit të Ministrave "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuessve të papunë femra", shfuqizohet.

26. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për nxjerrjen e udhëzimeve për zbatimin e mbikëqyrjen e programit dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e programit, nëpërmjet zyrave të punësimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.30, datë 18.1.2012

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRGJITHSHËM ANALITIK TË
PROJEKTAKTEVE, QË DO TË PARAQITEN PËR SHQYRTIM NË KËSHILLIN
E MINISTRAVE, GJATË VITIT 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2012, sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.32, datë 18.1.2012

**PËR KALIMIN E TITULLIT TË PRONËSISË SË SIPËRFAQES PREJ 900 M², TË
NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 2529, ME NUMËR PASURIE 737/3, LUNDËR,
TIRANË, QË DO TË TJETËRSOHEM NË FAVOR TË SUBJEKTIT KËRKUES “UNION
GROUP” SHPK, PËR LLOGARI TË FONDIT TË KOMPENSIMIT FINANCIAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 23 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e së drejtës së pronësisë të pasurisë së paluajtshme me nr.737/3, në zonën kadastrale 2529, me indeks harte K-35-100 (45-B), Lundër, Tiranë, me sipërfaqe 900 (nëntëqind) m², të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në favor të subjektit kërkues “Union Group” sh.p.k.

2. Vlera e sipërfaqes, që tjetërsohet, të përlllogaritet sipas vendimit nr.139, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse, për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës”, duke pasur parasysh edhe vlerën e kaparit, të paguar nga subjekti kërkues.

3. Vlera e sipërfaqes, që tjetërsohet, të paguhet nga subjekti kërkues “Union Group” sh.p.k., para lidhjes së kontratës dhe të derdhet për llogari të fondit të kompensimit financiar, të hapur pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

4. Autorizohet drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për lidhjen e kontratës së kalimit të së drejtës së pronësisë.



5. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.33, datë 18.1.2012

**PËR KALIMIN E TITULLIT TË PRONËSISË SË SIPËRFAQES PREJ 382 M², TË
NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 2529, ME NUMËR PASURIE 568/12, LUNDËR,
TIRANË, QË DO TË TJETËRSOHEM NË FAVOR TË SUBJEKTIT KËRKUES “UNION
GROUP” SHPK, PËR LLOGARI TË FONDIT TË KOMPENSIMIT FINANCIAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 23 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e së drejtës së pronësisë të pasurisë së paluajtshme me nr.568/12, në zonën kadastrale 2529, me indeks harte K-35-100 (45-B), Lundër, Tiranë, me sipërfaqe 382 (treqind e tetëdhjetë e dy) m², të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në favor të subjektit kërkues “Union Group” sh.p.k.

2. Vlera e sipërfaqes, që tjetërsohet, të përlllogaritet sipas vendimit nr.139, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse, për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës”, duke pasur parasysh edhe vlerën e kaparit, të paguar nga subjekti kërkues.

3. Vlera e sipërfaqes, që tjetërsohet, të paguhet nga subjekti kërkues “Union Group” sh.p.k., para lidhjes së kontratës dhe të derdhet për llogari të fondit të kompensimit financiar, të hapur pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

4. Autorizohet drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për lidhjen e kontratës së kalimit të së drejtës së pronësisë.

5. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.36, datë 18.1.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1210, DATË 11.12.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE
NË PËRDORIM TË KOMUNËS KUMAN, TË QARKUT TË FIERIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në llojin e transferimit të pronës nr.48, të komunës Kuman, të qarkut të Fierit, nga në përdorim, në pronësi, e inventarizuar në listën e miratuar me vendimin nr.1210, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave, sipas lidhjes nr.1 dhe formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kuman për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kuman

Lidhja nr.1

Numri rendor i pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
48	Tokë bujqësore joproductive	Në pronësi

VENDIM
Nr.37, datë 18.1.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.167, DATË 10.3.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE
NË PËRDORIM TË BASHKISË KUKËS, TË QARKUT TË KUKËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.167, datë 10.3.2010 të Këshillit të Ministrave, listës së inventarit i shtohen pronat me nr.795-957 (shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë-nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë), gjithsej 23 (njëzet e tre) fletë, sipas lidhjes nr.1 dhe formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.



2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Kukës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Kukës

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
795-941	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
943,944	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
945-952	Troje të lira dhe hapësira publike ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
953-957	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi

VENDIM
Nr.38, datë 18.1.2012

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “ARËZ” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3 shkronja “b” e 23, pika 3 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Arëz” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë “Fama” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Arëz”, të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.39, datë 18.1.2012

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE
MINISTRIA E BRENDSHME, PËR PREFEKTIN E QARKUT TË KUKËSIT, TË PRONËS
NR.481, ME EMËRTIM “DEGA E MOBILIZIMIT”, ME VENDNDODHJE NË KRUMË,
HAS DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Brendshme, për prefektin e qarkut të Kukësit, të pronës nr.481, me emërtim “Dega e mobilizimit”, në Krumë, Has, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi, për t’u përdorur për vendosjen dhe sistemimin e stacionit të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit (PMNZSH), të rrethit Has.

2. Prona nr.481, me emërtim “Dega e mobilizimit”, në Krumë, Has, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ministrisë së Brendshme dhe prefektit të qarkut të Kukësit u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, prefekti i qarkut të Kukësit dhe kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



MINISTRIA E MBROJTJES
DREJTORIA E EKONOMISË DHE PRIVATIZIMIT
ZYRA E INVENTARIZIMIT DHE TRANSFERIMIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME

RRETHI HAS

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Bashkia Krumë, Has										
Nr.	A			B			C			
	Zona kadastrale, indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emërtimi i pronës, adresa	Sip. totale e pronës në m ² ose MI	Nga sip. totale, sa ndërtime në m ²	Funksioni për të cilin përdoret prona	Enti me përgjegjësi administrative	Enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera, shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
481				Dega e mobilizimit Has	175 m ²	61 m ²	Për mbrojtjen	MM Q.Mobilizimit Kukës	Dega e mobilizimit Has	
				Godina e DM	61	61				
				Truall	114	-				

VENDIM

Nr.52, datë 1.2.2012

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.545, DATË 11.8.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRIN, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 4/2 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, kudo ku përmendet togfjalëshi “...institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit...” emërtimi “...Këshilli i Ministrave...” shfuqizohet, si dhe bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 1/2, shtohen emërtesat “Inspektorati Qendror” dhe “Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike”.

b) Në pikën 1/3 bëhen këto shtesa:

i) Në shkronjën “a” shtohen emërtesat “Avokatura e Shtetit” dhe “Autoriteti Rrugor Shqiptar” dhe shfuqizohet emërtesa “Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve”.

ii) Në shkronjën “b” shtohen emërtesat “Qendra Kombëtare e Artit dhe Kulturës” dhe “Cirku Kombëtar”.

iii) Në shkronjën “c” shtohet emërtesa “Drejtorja e Shërbimeve të Mijës dhe Peshkimit, Sarandë”.

c) Shkronja “c” e pikës 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Shtesa për kualifikim për nëpunësit në pozicionet “sekretar i Përgjithshëm”, “anëtar i organeve kolegjiale drejtuese me kohë të plotë të institucioneve të pavarura, të përcaktuara në pikën 1/1, të këtij vendimi”, “drejtor departamenti”, “drejtor i Përgjithshëm”, “drejtor drejtorie dhe pozicionet e veçanta të punës, të kategorizuara në kategorinë II-b ose më të lartë, sipas këtij vendimi, në institucionet e përcaktuara në pikën 1/1, të këtij vendimi”, “titullar dhe zëvendëstitullar i institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës”, “prefekt”, “nënprefekt”, si dhe funksionarët politikë “zëvendësministër”, e anëtarë të kabineteve politike përfitojnë shtesën për kualifikimin, gradën apo titullin shkencor, të përcaktuar sipas lidhjes nr.2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Kriteret e përfitimit të shtesës janë:

- Kjo shtesë jepet kur kualifikimi, grada apo titulli shkencor përputhen me përshkrimin e punës së nëpunësit, por pas miratimit, rast pas rasti, nga Departamenti i Administratës Publike, për Kryeministrinë, aparatet e ministrave të linjës, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit, institucionet qendrore në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit, si dhe nga njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore, për institucionet e pavarura.

- Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull shkencor më të lartë se ai i përcaktuar për pozicionin e tij, sipas lidhjes nr.2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfiton vetëm shtesën e përcaktuar për pozicionin.

- Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull shkencor më të ulët se ai i përcaktuar për pozicionin e tij, sipas lidhjes nr.2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfiton shtesën në përputhje me kualifikimin, gradën apo titullin shkencor që ka.

Në çdo rast, si më sipër, pavarësisht nga kualifikimi, grada apo titulli shkencor që ka nëpunësi, ai përfiton shtesën vetëm për gradën apo titullin shkencor më të lartë që ka.

Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimin përkatës në zbatim të kësaj pike.

Shtesa për kualifikim (kolona 4) e lidhjes nr.1, për të gjitha pozicionet e tjera të jetë 0.”.

ç) Në pikën 4/11, pas fjalëve “...Teatrin Kombëtar të Komedisë...”, shtohen fjalët “...Cirku Kombëtar...”

d) Pas pikës 8/1 shtohet pika 8/2, me këtë përmbajtje:

“8/2. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni”, në Inspektoratin Qendror dhe në Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike, janë sipas lidhjes nr.5/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

dh) Pas pikës 10/9 shtohet pika 10/10, me këtë përmbajtje:

“10/10. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve në Avokaturën e Shtetit janë sipas lidhjes nr.6/10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Nëpunësit e emëruar në Avokaturën e Shtetit, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, përfitojnë pagat, sipas përcaktimit të bërë në lidhjen nr.6/10.

Nëpunësit aktualë të Avokaturës së Shtetit, të cilët deri në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi përfitonin një pagë më të lartë sesa parashikohet në lidhjen nr.6/10, do të vazhdojnë të përfitojnë pagën aktuale.



Nëpunësi i emëruar jashtë vendit, në pozicionin “Jurist pranë Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Europës, i cili është përfaqësues i përhershëm pranë Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut”, ka statusin financiar të përfaqësuesit të ministrisë së linjës në përfaqësinë tonë diplomatike pranë BE-së.”.

e) Në pikën 11/1, pas fjalëve “...Teatrin Kombëtar të Komedisë...”, shtohen fjalët dhe “...Cirkun Kombëtar...”.

f) Lidhja nr.7/1 (pjesa I dhe II), që përmendet në pikën 11/1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtnë numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Punonjësit e tjerë mbështetës të Avokaturës së Shtetit, Autoritetit Rrugor Shqiptar, Qendrës Kombëtare të Artit dhe Kulturës, Drejtorisë së Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit, Sarandë dhe Cirkut Kombëtar, të paguhen sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës.

3. Efektet financiare të këtij vendimi janë, si më poshtë vijon:

- Për Inspektoratin Qendror dhe Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike, fillojnë nga data e emërimit në punë të nëpunësve/punonjësve.

- Për shtesat për kualifikimet, fillojnë nga data 1 janar 2012.

- Për të gjitha parashikimet e tjera, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Vendimi nr.407, datë 19.6.2003 i Këshillit të Ministrave “Për pagat në Avokaturën e Shtetit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 2/1

POZICIONI	KUALIFIKIMI/ GRADA/TITULLI SHKENCOR	SHTESA (LEKË/MUAJ)
Zëvendësministër	Profesor	30.000
Drejtor i Kabinetit të Presidentit/Kryetarit të Kuvendit/Kryeministrit/Zëvendëskryeministrit	Profesor i asociuar	25.000
Këshilltar i Presidentit/Kryetarit të Kuvendit/Kryeministrit/Zëvendëskryeministrit		
Ndihmës i Presidentit/Kryetarit të Kuvendit/Kryeministrit		
Sekretar i Përgjithshëm		
Prefekt		
Titullar i institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit, apo ministrave të linjës		
Anëtar i organeve kolegjiale drejtuese me kohë të plotë të institucioneve të pavarura të përcaktuara në pikën 1/1 të vendimit		
Ndihmës i Zëvendëskryeministrit	Studime post master sipas përcaktimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, apo të barazvlefshme me to në vendet e përcaktuara sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit	20.000
Drejtor Kabineti i Ministrit/ titullarëve të institucioneve të pavarura të përcaktuara në pikën 1/1 të vendimit		
Këshilltar i Ministrit/ titullarëve të institucioneve të pavarura të përcaktuara në pikën 1/1 të vendimit		

Zëvendëstitullar i institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit, apo ministrave të linjës Nënprefekt Drejtor Departamenti Drejtor i Përgjithshëm Drejtor Drejtorie dhe pozicionet e veçanta të punës, të kategorizuara në kategorinë II-b, ose më të lartë, sipas këtij vendimi, në institucionet e përcaktuara në pikën 1/1 të vendimit.	dhe Shkencës, Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrit të Financave	
	Doktor i Shkencave	20.000
	Doktor i Shkencave në vendet e përcaktuara sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrit të Financave	25.000

Lidhja nr. 7/1

NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË TRUPËS ARTISTIKE NË TEATRIN KOMBËTAR, TEATRIN KOMBËTAR TË OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR, NË DREJTORINË E TEATRIT TË FËMIJËVE NË QENDRËN KOMBËTARE TË KULTURËS PËR FËMIJË DHE TEATRIN KOMBËTAR TË KOMEDISË

I- Për Teatrin Kombëtar dhe Drejtorinë Artistike të Teatrit të Operës dhe Baletit në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor

Nr	Pozicioni	Paga
1	Dirigjent Regjisor Solist i parë Koncertmaester Baletmaestër Aktor i parë	76.300 lekë
2	Asistent dirigjent Asistent regjisor Solist II (spala sektori) Aktor i dytë	68.100 lekë
3	Orkestrant i kategorisë së parë Korist i kategorisë së parë Balerin i kategorisë së parë Skenograf i kategorisë së parë	56.900 lekë
4	Aktor i tretë	55.900 lekë
5	Orkestrant i kategorisë së dytë Korist i kategorisë së dytë Balerin i kategorisë së dytë Skenograf i kategorisë së dytë	46.700 lekë



II- Për Drejtorinë Artistike të Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor, Drejtorinë e Teatrit të Fëmijëve në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatrin Kombëtar të Komedisë dhe Cirkun Kombëtar

Nr	Pozicioni	Paga
1	Dirigjent Regjisor Drejtues artistik	68.100 leke
2	Solist i parë Orkestrant i kategorisë së parë Aktor i parë Skenograf i kategorisë së parë Korist i kategorisë së parë Valltar i kategorisë së parë Akrobat i kategorisë së parë Mjeshtër i studios së cirkut Mjeshtër profili i numrave të cirkut	56.900 lekë
3	Solist i dytë Orkestrant i kategorisë së dytë Aktor i dytë Skenograf i kategorisë së dytë Korist i kategorisë së dytë Valltar i kategorisë së dytë Akrobat i kategorisë së dytë	46.700 lekë

Lidhja nr. 6/10

KATEGORITË E PAGAVE PËR AVOKATËT E SHETIT DHE PËR NËPUNËSIT, NË AVOKATURËN E SHETIT NË NIVEL QENDROR DHE VENDOR

Emërtesa	Kategoria e pagës	Shtesa për kushte pune
Në Avokaturën e Shtetit në nivel qendror		
Avokat i Përgjithshëm i Shtetit	II-a	10.000
Avokat i Shtetit	II-b	10.000
Jurist	III-b	
Specialist	IV-a	
Sekretar	IV-b	
Në Avokaturën e Shtetit në nivel vendor		
Kryetar i zyrës vendore të Avokaturës së Shtetit, Tiranë	II-b	
Kryetar i zyrës vendore	III-a	
Avokat i Shtetit pranë zyrës vendore	III-b	
Avokat i Shtetit pranë ministrive	III-b	
Sekretar	IV-b	

Lidhja nr. 5/3

KATEGORITË E PAGAVE DHE SHITESAT PËR KUSHTE PUNE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË NËPUNËSVE PËR EMËRTESAT “SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR INSTITUCIONI” NË INSPEKTORIATIN QENDROR DHE NË AGJENCINË KOMBËTARE PËR SIGURINË KOMPJUTERIKE

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHITESA PËR KUSHTE PUNE
Titullari i institucionit	II-a	1	15.000
Drejtor drejtorie	II-b	1	15.000
Përgjegjës sektori	III-a/1	1	20.000
Specialist	III-b	1 ose 2	25.000

VENDIM

Nr.59, datë 1.2.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E FINANCAVE, PËR NGRITJEN E SISTEMIT TË MONITORIMIT DHE FISKALIZIMIT TË LOJËRAVE TË FATIT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Financave, të shtohet fondi prej 200 000 (dyqind mijë) USD në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, për të përballuar kontributin e qeverisë shqiptare në asistencën teknike të ofruar nga PNUD-i për ngritjen e sistemit të monitorimit dhe fiskalizimit të lojërave të fatit në Shqipëri.

2. Kundërvlehtë në lekë e shumës së përmendur në pikën 1, të përballohet nga fondi i rezervë i buxhetit, për vitin 2012.

3. Ky fond i kthehet qeverisë shqiptare nga fituesi i koncesionit të sistemit online të monitorimit të lojërave të fatit.

4. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



URDHËR
Nr.11, datë 18.1.2012

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për Ministrinë e Brendshme, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, zotit Florjan Nuri.
2. Këto kompetenca do të ushtrohen deri në datë 31 dhjetor 2012.
3. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij urdhri. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

VENDIM
Nr.1, datë 16.1.2012

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË KESH SHA PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE PËRKATËSISHT: “NËNSTACIONI LANABREGAS”, “NËNSTACIONI BOGOVË”, “NËNSTACIONI GJANÇ”, “NËNSTACIONI BUSHAT 110/20KV”, “RRJETI 20 KV KOPLIK”, “NËNSTACIONI SHKODËR 110/20KV”, “NËNSTACIONI FIER 110/20KV”, “NËNSTACIONI GJIROKASTËR”, “NËNSTACIONI 110/20 KV SARANDË” TEK SHOQËRIA “CEZ SHPËRNDARJE” SHA

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika “1” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 7, 10 pika 1 dhe nenit 11 të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr.89, datë 13.12.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikës 1.3 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.1.2012, pasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të aseteve nga shoqëria KESH sh.a. tek shoqëria “CEZ shpërndarje” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë KESH sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2, emri dhe adresa e plotë e të licencuarit (Janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte.).
 - Neni 7, pika 1.3, geramat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.).
 - Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5 (Ky informacion është plotësuar tërësisht.).
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë KESH sh.a., “Për transferimin e asetëve, përkatësisht të: “Nënstacionit Lanabregas”, “Nënstacionit Bogovë”, “Nënstacionit Gjanç”, “Nënstacionit Bushat 110/20 kv”, “Rrjetit 20 Kv Koplik”, “Nënstacionit Shkodër 110/20 Kv”, “Nënstacionit Fier 110/20 Kv”, “Nënstacionit Gjirokastrë”, “Nënstacionit 110/20 kv Sarandë” tek shoqëria “CEZ shpërndarje” sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr.2, datë 16.1.2012

**PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME
SERI PM09SH, NR.77, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË
ERE-S NR.23, DATË 25.3.2009 PËR SHOQËRINË KESH SHA**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.2, 2.3 dhe 2.5 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe neneve 10, 15 pika 2 germa “c”, pika 4 germat “a” dhe “b”, 17 pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.1.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë KESH sh.a., për ndryshimin e licencës nr.77, seria PM09SH, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.23, datë 25.3.2009 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit siç kërkohet nga rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “KESH” sh.a., plotëson kërkesat ligjore, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: Informacioni me shkrim, ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.

- Neni 15, pika 4, germa “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën me nr.77, seria PM09SH, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.23, datë 25.3.2009 për shoqërinë KESH sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.3, datë 16.1.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “PESHKU PICAR 1” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “PICARI 1”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1, germa “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.1.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Peshku Picar 1” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Peshku Picar 1” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Peshku Picar 1” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec Picar 1”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.4, datë 16.1.2012

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES “HEC KLOS” TË SHOQËRISË
“MALIDO ENERGJI” SHPK SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “II”, 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9 pikat 1 dhe 2, germa “a”, të rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.1.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Malido Energji” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për “Hec Klos” si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Malido Energji” sh.p.k., është konform rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrik nga burimet e rinovueshme të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1 , gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 4, germa “a”, “b”, “c”

Është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kualifikimin e impiantit prodhues “Hec Klos” të shoqërisë “Malido Energji” sh.p.k. si burime të rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr.5, datë 16.1.2012

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “MALIDO ENERGJI” SHPK NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 5 pika 2, neneve 13 dhe 14 pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.1.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Malido Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Malido Energji” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Malido Energji” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.6, datë 16.1.2012

PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS PËR NDËRTIMIN, INSTALIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E CENTRALIT ELEKTRIK, SI DHE PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME SERI NPM06K, NR.41, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.83, DATË 27.11.2006 PËR SHOQËRINË ENERGO-SAS SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 e “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe neneve 13, 14, 15 pikat 1 dhe 2 germa “b”, dhe pikat 3 dhe 4, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.1.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Energo-SAS” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr.41, seria NPM06K, për ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centralit elektrik, si dhe prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.83, datë 27.11.2006 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energo-SAS” sh.p.k., plotëson kërkesat e rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.

- Neni 15, pika 4, germa “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë modifikimin e licencës me nr.41, seria NPM06K, të shoqërisë “Energo-SAS” sh.p.k. “Për ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centralit elektrik, si dhe prodhimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.83, datë 27.11.2006.

2. Fuqia e instaluar e Hec-it “Sasaj” nga 7 MW bëhet 8.6 MW.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr.54, datë 16.1.2012, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Nazmi Gazidedja, i datëlindjes 6.8.1946.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 8.2.2012
Doli nga shtypi më 10.2.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 44 lekë